



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E SHENDETESISE  
*/Kabineti/*

Bulevardi "Bajram CURRI" Tirana, Albania Tel. +355 43 / 629 37


Nr. 3819 Prot.

Tirane, me 19.12. 2002

MIRATOHET

MINISTRI

Mustafa XHANI



RREGULLORE PER ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E LABORATOREVE  
MIKROBIOLOGJIKE PRIVATE

Kjo rregullore bazohet ne Ligjin Nr. 7761 date 19.10.1993 " Per parandalimin dhe luftimin e semundjeve ngjitese" , ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 500 date 23.11.1992 " Per ushtrimin e profesionit ne fushen e mjeksise ne profesion te lire privat " , Urdherin Nr.108 date 19.04.2002 " Per dhenien e licenses per ushtrim te profesionit ne fushen e shendetesise ne profesion te lire privat " .

Ne kete rregullore paraqitet menyra e organizimit te laboratoreve mikrobiologjike privat si dhe kushtet qe duhen plotesuar per marrjen e lejes per hapjen e tyre .

Qellimi i kesaj rregulloreje eshte ngritja e nivelit profesional te sherbimeve ne laboratoret mikrobiologjike private .

1. Per hapjen dhe funksionimin e laboratoreve mikrobiologjike private , drejtuesi teknik I laboratorit duhet te jetë i diplomuar ne Fakultetin e Mjeksise ( ose te Biologjise ) \*  
dhe te kete kryer kursin tre vjecar pasuniversitar te specializimit ne mikrobiologji ( si dhe kurse pasuniversitare te specializimit ne mikrobiologji te kryera ne institucione jashtë vendit dhe te ekuivalentuara ne Fakultetin e Mjeksise ne Shqiperi ).

2. Ne laboratoret mikrobiologjike private lejohen te punesohen edhe laborante mikrobiologe , te cilet kane kryer kurset-e-kualifikimit per laborante mikrobiologe.

3. Laboratori mikrobiologjik duhet te kete keto mjedisë te nevojshme :

a)- Laboratori mikrobiologjik duhet te jete ne mjedis me vehte , mundesisht jo ne komunikim me persona qe nuk kane lidhje me kete proces .

b)- Laboratori duhet te kete keto mjedisë te domosdoshme :

- Mjedisi I laboratorit ( me siperfaqe mbi 15 m<sup>2</sup> ).
- Mjedisi I preparaturise .
- Mjedisi I larjes, dezinfektimit , sterilizimit .
- Mjedis per pranimin e materialeve patologjike dhe dokumentacionit te laboratorit .
- Mjedisi sanitari ( WC, dush) .

Ne te gjitha mjediset te jete I instaluar uje I rrjedhshem , I ftohte e I ngrohte .

4. Per funksionimin e laboratoreve mikrobiologjike duhet te jene keto pajisje :

- Termostat .
- Mikroskop .
- Aerosteril .
- Autokllave .

- Centrifuge.
- Frigorifer.

5. Per funksionimin normal te laboratoreve mikrobiologjike duhet te sigurohet energji elektrike e vazhdueshme . (*te teta generator*) ?

6. Materialet e punes si : reagente , kite , antigene diagnostike te sigurohen vetem nga subjekte te licensuara .

7. Laboratori mikrobiologjik lejohet te hapet pas verifikimit *Formular*  
dhe dokumentit te miratimit te leshuar nga Instituti I Shëndetit  
Publik ne bashkepunim me specialistet mikrobiologe mbi bazen  
e vleresimit ne vend. *Shembull*

8. Me pas dokumentacioni I nevojshem , I percaktuar nga Komisioni I Posacem per Dhenien e Licensave Profesionale se bashku me dokumentin e miratimit te hapjes se laboratorit mikrobiologjik , dorezohen prane Sektorit te Licensimit te Aktivitetit Privat ne Ministrine e Shendetesise per marjen e licenses. Licensa eshte e vlefshme per nje periudhe 2(dy)vjecare me te drejte rinnovimi. *(Sjet)*

9. Per laboratoret mikrobiologjike do te jepet license per shoqerine , drejtuesin teknik dhe do te licensohet detyrimi i gjithe personeli I larte dhe I mesem mjekosor I punesuar ne te.

10. Laboratori mikrobiologjik duhet te pajiset me :

- Rregjistrin e egzaminimeve laboratorike , ku te shenohet koka e rregjistrat ( numri rendor , idenditeti , mosha , lloji I ekzaminimit dhe rezultati ) .
- Rregjister dhe flete deklarimi fillestar te semundjeve ngjitese .

11. Personeli I laboratorit mjek mikrobiologe dhe laborante duhet te disponojne dhe te njojin aktet ligjore dhe nenligjore te

3.

semundjeve ngjitese , vecanerisht ato mbi menyren e deklarimit te tyre .

12 . Laboratoret mikrobiologjike raportojne sipas ligjit te semundjeve ngjitese ne Sherbimin Epidemiologjik te Rrethit numrin , llojin e ekzaminimit dhe pozitivitetin ( periodikisht cdo tre muaj numrin , llojin e ekzaminimit , pozitivitetin etj.) dhe ky I fundit e percjell informacionin ne Institutin e Shendetit Publik.

13 Per cdo ndryshim ose shtese te ambjentit procedura e marrjes se lejes fillon nga e para .

14. Per cdo ndryshim te ekzaminimeve nga lista e miratimit fillesttar , behet njoftimi ne Sektorin e Licensimit te Aktivitetit Privat ne Ministrine e Shendetesise .

15. Instituti I Shendetit Publik dhe Sektori I Licensimit te Aktivitetit Privat ne Ministrine e Shendetesise ushتروجne kontolle periodike ne laboratoret mikrobiologjike private .